

## **1. Përfundon projekti teknik i Restaurimit të dy ndërtesave karakteristike “Babameto”**



Pas një pune disamujore, projektet teknike për restaurimin e dy ndërtesave Babameto përfunduan dhe u miratuan në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve.

Miratimi i projekteve do të pasohet menjëherë me zbatimin e restaurimit, pasi të nënshkruhet marrëveshja përkatëse edhe me familjen Babameto, pronare e këtyre 2 ndërtesave.

Projekti i restaurimit dhe rijetëzimit të ndërtesave “Babameto” është pjesë e programit “Gjirokastra 2008-2011”, bashkëpunim i GCDO-së me organizatën suedeze Trashëgimi Kulturorë pa Kufinj, financuar nga agjencia suedeze për bashkëpunim ndërkombëtar SIDA dhe Packard Humanities Institute. Programi përfshin gjithashtu organizimin e disa kampeve ndërkombëtare të restaurimit dhe trajnimit e arkitektëve të rinj.

## **2. Zbulohet një furrë (?) e vjetër gjatë punës për ngritjen e Muzeut “Kronikë në Gur”**

Punimet restauruese në galerinë ku do të vendoset muzeu “Kronikë në gur” po shkojnë drejt përfundimit. Po punohet për pastrimin dhe mbushjen e fugaturave të mureve, heqjen e tonelatave mbeturina nga restaurime të mëparshme, izolimin e dyshemesë, instalimin e një sistemi të ri ndriçimi dhe instalimeve elektrike etj.

Ndërkohë një harkadë e re u hap, u pastrua dhe iu shtua hapësirës së muzeut, duke rritur sipërfaqen e tij. Këtu u zbulua një objekt i panjohur deri tani që mendohet të ketë qenë furrë gatimi e Mesjetës së vonë. Priten studime më të



detajuara të specialistëve përkatës ndërkohë që “furra” mendohet të ekspozohet siç është në muzeun e ri.

Ndërkohë vazhdon puna për përcaktimin e përmbajtjes dhe dizajnit të muzeut, i cili do të jetë njëkohësisht një hapësirë multifunktionale kulturore.

GCDO sapo nisi një program kërkimi nëpër arkivat shtetërore dhe private si dhe konsultat në Gjirokastrë në kërkim të materialeve dokumentare apo të dhënave gojore. Në Gjirokastrë bëri një vizitë Diana Walters, specialiste nga universiteti i Goteborgut, e cila vlerësoi paraprakisht një potencial të madh për një muze kushtuar Gjirokastrës dhe luginës së lumit Drino. Qëndrimi i saj u bë i mundur përmes ndihmës së organizatës Trashëgimi Kulturor pa Kufinj.

### 3. Restaurimi i Qendrës së re të Artizanatit drejt përfundimit



Restaurimi i Qendrës së re të Artizanatit në Qafën e Pazarit, i financuar nga programi dy vjeçar i UNDP/UNESCO “Trashëgimia dhe Kultura për Zhvillim Shoqëror Ekonomik”, po i afrohet përfundimit. Së shpejti në këtë ndërtesë do krijohet kështu një ansambël i tërë me një sipërfaqe prej rreth 200 metra katror, që i kushtohet zhvillimit të Artizanatit, mu në qendër të Gjirokastrës Historike. Qendra e artizanatit do të shërbejë për kualifikimin dhe rikualifikimin e artizanëve. Në të njëjtën ndërtesë do krijohen edhe 2 punishte, ku mjeshtrit do të demonstrojnë aftësitë e tyre drejtpërdrejt për turistët. Një hap i mëtejshëm është menduar krijimi i Inkubatorit të Artizanatit, që do të nxisë të rinjtë të zhvillojnë biznesin e vogël në këtë fushë.

### 4. Fillon sezoni turistik në Gjirokastrë

Muaji mars shënon fillimin e sezonit të ri turistik në Gjirokastrë, ndërkohë që Zyra e Informimit Turistik, projekt i GCDO-së, mbush 3 vjet nga veprimtaria e saj në shërbim të vizitorëve. Një mjedis i ri pritet të krijohet së shpejti në sheshin e Çerçizit për ZIT, në sajë të bashkëpunimit trepalësh UNDP/UNESCO, Bashkia Gjirokastrë dhe GCDO.



Punimet e restaurimit tashmë kanë filluar. Përvoja e pasur e krijuar në 3 vjet për shërbimin ndaj turistëve, por edhe për studimin e kapaciteteve turistike të qytetit, kërkesat e vizitorëve, studimin e përbërjes dhe interesave të tyre, promovimin e vlerave të qytetit etj. pritet të ngrihet në një shkallë më të lartë në Zyrën e re. Administrimin e saj do e marrë përsipër Bashkia e qytetit me asistencën teknike të GCDO-së.

Mbi 12 993 turistë vizituan Gjirokastrën për vitin 2009. Kjo shifër shënon një rritje prej 8.9% krahasuar me 2008 dhe 116% krahasuar me 2007.

## **5. Marrëveshje bashkëpunimi me CESVI-n, Përmet**

GCDO nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me organizatën italiane CESVI, që po zbaton një projekt tre vjeçar zhvillimi në Përmet. Të dyja organizatat do të punojnë së bashku për zhvillimin e turizmit në rajonin e jugut. GCDO do të verë në dispozicion të CESVI-t përvojën e saj tashmë shumëvjeçare për zhvillimin e turizmit në Gjirokastrë.

## **6. Kritja e partneritetit ndërkombëtar**



GCDO është tashmë anëtare e SEE (Trashëgimia e Europës Juglindore), një rrjet organizatash vullnetare, e pavarur jo qeveritare, jopolitike dhe jo fitimprurëse nga vende të rajonit që punojnë në fushën e trashëgimisë kulturore. GCDO mbështet strategjinë e rijetëzimit, përmes së cilës forcohet dialogu dhe ndihmohen zgjidhjet për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Gjirokastrë dhe në rajon në përgjithësi.

## **7. Trajnimi i stafit të GCDO – së për projekt - propozime pranë Bashkimit Europian**

Gjatë muajit shkurt 2010, stafi i GCDO mori pjesë në dy trajnime të organizuara nga TACSO - Asistenca Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile. Trajnimi i parë i organizuar kishte në fokus njohjen me projektin TACSO, ndërsa i dyti me temë “Mbi

Procedurat e Aplikimit për Grantet nga BE” u organizua në Gjirokastrë me pjesëmarrjen e shoqatave të ndryshme të rajonit.

## 8. Specialist ndërkombëtar për zhvillimin e turizmit të trashëgimisë kulturore në stafin e GCDO-së

Stephan Doempke, specialist gjerman me përvojë ndërkombëtare, erdhi në Gjirokastrë me një kontratë dyvjeçare me GCDO-në. Punësimi i tij si Koordinator për Turizmin e Trashëgimisë Kulturore u mundësua përmes projektit Programi i Ekspertëve të Integruar, i organizatës gjermane CIM, e cila pranoi në dhjetor kërkesën përkatëse nga GCDO.

Doempke ka një përvojë të gjatë punë në vende të ndryshme të botës. Për një vit ai ishte koordinator kombëtar i projektit të përbashkët të UNDP/UNESCO “Trashëgimia dhe Kultura për Zhvillim Shoqëror dhe Ekonomik”, ku pati rast të njihet në thellësi me Gjirokastrën dhe GCDO-në. *“Vij me dëshirë të madhe të punoj dhe jetoj këtu - tha Doempke - Me potencialin e madh që ka si qytet dhe rajon, Gjirokastra përbën një sfidë interesante për çdo specialist të turizmit kulturor. Jam i sigurt në perspektivën e saj në këtë fushë.”*



## Faleminderit !

*\*Për më shumë informacion rreth GCDO-së dhe përpjekjeve të saj në Gjirokastrë, lutemi drejtojeni drejtorit Sadi Petrela në [spetrela@gjirokastra.org](mailto:spetrela@gjirokastra.org) ose në cel 06920 78767.*



**Pranverë në Gjirokastrë**